



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

Nr. 05, datë 28/06/2021

**“PËR MIRATIMIN E PESË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË APELIMIT”, NË  
KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE  
NË AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE”.**

Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike i mbledhur sot në datë 28/06/2021, mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, nenin 36, 37 (Senati Akademik), nenin 38 (Funkcionet e Senatit Akademik), e nenin 131, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, pasi diskutoi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Apelimit, në zbatimin e nenit 37 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”:

## VENDOSI

Miratimin e pesë anëtarëve të Komisionit të Apelimit:

1. Altin Skënderaj , Instituti i Arkeologjisë
2. Albana Mema, Instituti i Historisë
3. Mimoza Shqefni, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit
4. Arian Leka, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
5. Raimond Perolla, Juristi i ASA-së

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**AKADEMIK PROF. DR. MARENGLIEN VERDI**

